



DIVIZIONI I FURNIZIMIT

PROCEDURA E LEXIMIT DHE FATURIMIT TË KONSUMATORËVE TARIFORË

Shkurt, 2010
Rishkruar: 31.07.2013

1. Hyrje

- 1.1 Kjo Procedurë është përgatitur nga Kompania kosovare për distribuim dhe furnizimi me energji elektrike Sh.a. dhe është në përputhshmëri me obligimin e përcaktuar me nenin 24.3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe do të hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
- 1.2 Kjo procedurë përcakton veprimet që janë në përputhje të plotë me Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si dhe Licencat e Divizionit të Shpërndarjes dhe Divizionit të Furnizimit që kanë të bëjnë me leximin dhe faturimin e saktë të pikës matëse.
- 1.3 Bazuar në nenin 4.3 pika f) të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji , Operatori i Sistemit (Divizioni i Shpërndarjes) duhet të sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve. Bazuar në nenin 20.1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Divizioni i Shpërndarjes ia ka besuar Divizionit të Furnizimit leximin e konsumatorëve të grupeve tariforë 4, 5, 6, 7 dhe 8. (Shih Marrëveshjen e bashkangjitur). Divizioni i Shpërndarjes obligohet që të bëjë leximin e njehsorëve të konsumatorëve të grupeve tariforë 0, 1, 2 dhe 3.
- 1.4 Faturimi i energjisë së shpenzuar bëhet nga Divizioni i Furnizimit në bazë të tarifave të aprovuara nga ZRRE në përputhje me Rregullin mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulli i Çmimeve) dhe duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga furnizuesi ose operatori i rrjetit për çdo periudhë të faturimit ashtu siç janë përcaktuar në kontratën për furnizim.

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura më poshtë kanë këto kuptime:

“Furnizues publik” nënkupton Divizionin e Furnizimit i cili furnizon konsumatorët me energji elektrike, i cili për veprimtarinë që ushtron posedon një licencë nga ZRRE-ja.

“Distrikt” nënkupton Njësinë organizative në kuadër të Divizionit të Furnizimit me 7 (shtatë) qendra në Kosovë.

„Konsumator“ do të thotë konsumatori për blerje me shumicë ose konsumatori i fundit i energjisë.

“Pika Matëse” nënkupton vendin fizik ku është instaluar sistemi i matjes së energjisë elektrike.

“Listë leximi” nënkupton listën e një shtegu të konsumatorëve ku evidentohet shpenzimi mujor i energjisë elektrike.

“Pajisje elektrike HHU” nënkupton pajisjen elektronike në të cilën vendosen dhe ruhen gjendjet e leximit.

“Shteg leximi” nënkupton regjistrin e radhitjes së konsumatorëve sipas daljeve 10/0,4 kV.

“Koordinator i nën-distriktit” nënkupton punonjës in përgjegjës për disa specialistë të daljeve 10 kV.

“Specialist i daljes” nënkupton punonjës in përgjegjës për rrjedhën e energjisë elektrike të daljes 10 kV.

“CCP” nënkupton pakon për kujdes ndaj konsumatorit.

“Operator i sistemit distributiv (shpërndarës)” nënkupton personin juridik që është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes, dhe nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit distributiv (shpërndarës), në një zonë të caktuar dhe ku është e mundshme, ndërlihdjen e këtij sistemi me sisteme tjera dhe për sigurimin e mundësive afat-gjata të sistemit, që të mbulojë kërkesat e arsyeshme për distribuimin e energjisë elektrike apo gasit natyror.

“Sektori i faturimit të distriktit” nënkupton shërbimi i cili bënë faturimin e energjisë elektrike në distrikt.

“Zyra e Rregullatorit për Energji” është organ i pavarur rregullator që është themeluar sipas Ligjit Nr. 2004 /9 “Për Rregullatorin e Energjisë”.

Çdo term tjetër i përdorur në këtë procedurë do të ketë të njëjtin kuptim si termat e përdorura në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

2. Përgatitjet për lexim

- 2.1 Procesi fillon me hapjen e periodës për lexim, vendosjen e shtigjeve për lexim, shtypjen e listave të leximit dhe futjen e shtigjeve të leximit në HHU sipas daljeve 10 kV nga CCP, të radhitura sipas specialistëve të daljes dhe shtigjeve të leximit. Çdo shteg është radhitur për të mundësuar metodë më efikase për lexuesin. Kjo bëhet 2 deri 3 ditë para datës së leximit të njehsorëve. Sektori i faturimit është përgjegjës për nxjerrjen e listave të leximit, riradhitjen e konsumatorëve në shteg dhe dorëzimin e tyre te koordinatorët e nën-distrikteve.
- 2.2 Konsumatorët e të gjitha distrikteve duhet të lexohen brenda një afati kohor prej 4 - 5 ditë pune duke përfshirë çdo rilexim dhe verifikim nga ana e Specialistëve të Daljeve. Koordinatorët e nën-distrikteve duhet të bëjnë përpjekje që t'i lexojnë të gjitha daljet përafërsisht në të njëjtën ditë pune për çdo muaj.

3. Leximi dhe evidentimi i gjendjes

- 3.1 Leximi i njehsorëve duhet të përfshijë periudhën një mujore të shpenzimit të energjisë. Data e leximit të çdo konsumatori do të jetë e njëjtë si e leximit paraprak me maksimum ± 2 (dy) ditë pune. Në rast se data e leximit dhe toleranca e lejuar 2 (dy ditë) i bie të jetë në fund të javës ose gjatë festave shtetërore atëherë periudha kohore e shpenzimit të energjisë elektrike mund të shkurtohet ose të zgjatet për aq sa zgjasin këto festa.

4. Leximi i konsumatorëve në grupin tarifar 0 (zero) - niveli 110 kV

- 4.1 Leximi i konsumatorëve të grupit tarifor 0 (zero) (niveli i tensionit të furnizimit 110 kV) bëhet nga Sektori i Matjeve të energjisë elektrike në kufirin KEDS - KOSTT, gjegjësisht Sektori për leximin e njehsorëve në distancë (AMR) **me datë 01 të çdo muaji**. (Leximi në anën primare bëhet nga KOSTT – i, ndërsa në anën sekondare nga KEDS).
- 4.2 Leximi i njehsorëve të konsumatorëve të grupit tarifor 0 (zero) bëhet në prezencën e konsumatorit, ku gjendja e njehsorëve (leximi) verifikohet dhe nënshkruhet nga të dy palët.
- 4.3 Gjendjet e konsumatorëve të grupit tarifor 0 (zero) dorëzohen deri me datën 03 të muajit aktual.

5. Leximi i konsumatorëve në grupin tarifor 1 (niveli 35 kV), 2 (niveli 10 kV) dhe 3 (niveli 0.4 kV kategoria I)

- 5.1 Leximi i konsumatorëve të grupit tarifor 1 (një) (niveli i tensionit të furnizimit 35 kV), grupit tarifor 2 (dy) (niveli i tensionit të furnizimit 10 kV) dhe grupi tarifor 3 (tre) (niveli i tensionit të furnizimit 0.4 kV ku bëjnë pjesë konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive) bëhet nga ekipet profesionale të Sektorit të Matjeve të secilit Distrikt të Divizionit të Shpërndarjes. Leximi bëhet në periudhën e njëjtë kohore sikurse konsumatorët e grupeve tjera tarifore.
- 5.2 Leximi i këtyre grupeve matëse me maksigraf do të bëhet në formë periodike një mujore, data e leximit do ti bëhet e njohur konsumatorit përmes divizionit të furnizimit dhe kjo datë e leximit do të respektohet nga operatori i sistemit përveç rasteve të festave zyrtare dhe ditëve të vikendeve.
- 5.3 Leximi i njehsorëve të konsumatorëve të grupeve tarifore 1, 2, 3, do të bëhet në prezencën e konsumatorit, ku gjendja e njehsorëve (leximi) verifikohet dhe nënshkruhet nga të dy palët.

6. Leximi i konsumatorëve të grupeve tarifore 4, 5, 6, dhe 8

- 6.1 Leximi i njehsorëve elektrik të grupeve tarifore 4 (katër) (kategoria II), 5 (pesë) (konsumatorët shtëpiak të nivelit 0.4 kV me matës dy tarifor), 6 (gjashtë) (konsumatorët shtëpiak të nivelit 0.4 kV me matës një tarifor) dhe të grupit tarifor 8 (tetë) (Ndriçimi Publik) bëhet çdo muaj nga specialistët e daljeve 10 kV.

7. Faturimi i konsumatorëve të grupit tarifor 0 (zero) (niveli 110 kV)

- 7.1 Sektori i leximit në distancë (AMR), leximet e bëra i përcjell në Departamentin e Faturimit ku bëhet shtypja (prodhimi) i faturave për konsumatorët e këtij grupi tarifor.
- 7.2 Faturimi i konsumatorëve të grupit tarifor 0 (niveli 110 kV) do të bëhet sipas Sistemit Tarifor të aprovuar nga ZRRE.
- 7.3 Faturat e prodhuara nga Departamenti i Faturimit u dërgohen këtyre konsumatorëve personalisht me proces të pranimit – dorëzimit.

8. Faturimi i konsumatorëve të grupeve tarifore 1 (niveli 35 kV), 2 (niveli 10 kV) dhe 3 (niveli 0,4 kV kategoria I)

- 8.1 Ekipet profesionale të sektorit të matjeve të secilit distrikt fletë leximet i dorëzojnë tek Sektori i Faturimit, i cili Sektor në afatin kohor brenda 24 orëve bënë vendosjen e gjendjeve të pranuar në CCP dhe bënë gjenerimin e Faturave për këta konsumatorë.
- 8.2 Faturimi i konsumatorëve të grupeve tarifore 1 (niveli 35 kV), 2 (niveli 10 kV) dhe 3 (niveli 0,4 kV kategoria I) do të bëhet sipas Sistemit Tarifor të aprovuar nga ZRRE.
- 8.3 Faturat e prodhuara përmes specialistëve të daljeve u dërgohen konsumatorëve të këtyre grupeve tarifore.

9. Faturimi i konsumatorëve të grupeve tarifore 4, 5, 6, 7 dhe 8

- 9.1 Specialistët e daljeve fletë leximet i dorëzojnë tek Sektori i Faturimit, i cili Sektor në afatin kohor brenda 24 orëve bënë vendosjen e të dhënave të pranuar në CCP dhe bënë prodhimin e Faturave për këta konsumatorë.
- 9.2 Faturimi i konsumatorëve të grupeve tarifore 4, 5, 6 dhe 8 do të bëhet sipas Sistemit Tarifor të aprovuar nga ZRRE.
- 9.3 Faturat e prodhuara përmes specialistëve të daljeve u dërgohen konsumatorëve në fjalë.

10. Analiza e kualitetit të shënimeve

- 10.1 Të dhënat (gjendjet) nga leximet e njehsorëve gjatë periudhës së leximit dhe faturimit vendosen në CCP. Pasi që të vendosen të gjitha leximet për një shteg, sektori i faturimit menjëherë bënë analizën e atij shtegu dhe nxjerr raporte të veçanta të cilat tregojnë shpenzim shumë të lartë, shpenzim zero, shpenzim negativ, apo njehsorët e palexuar. Raportet i dërgohen Udhëheqësit të Sektorit të Faturimit të Distriktit, i cili pas analizës së bërë nxjerr listën e konsumatorëve të cilët nevojiten të verifikohen apo rilexohen dhe të njëjtën e dërgon te koordinatorët. Kjo duhet të bëhet përmes procesverbalit të Pranim – Dorëzimit.
- 10.2 Brenda 24 orëve koordinatorët obligohen të bëjnë verifikimet apo rileximet dhe përmes procesverbalit të Pranim – Dorëzimit të njëjtat ti kthejnë te Sektori i Faturimit. Specialistët e daljeve obligohen që në të gjitha fletë leximet në rastet kur nuk kanë çasje apo me shpenzim zero – të japin sqarime shtesë – komente me shkrim. Në bazë të sqarimeve të dhëna, sektori i faturimit bënë faturimin e këtyre konsumatorëve me mesatare të shpenzimit paraprak (në rastet kur potencohet se ka shpenzim) apo përshkruan gjendjen e njëjtë (në rastet kur ceket se nuk ka shpenzim).
- 10.3 Pasi që të gjitha ri – leximet, verifikimet e kërkuara për shtigje të jenë futur në CCP, shtegu mund të mbyllet dhe faturat për konsumatorë të shtypen brenda 2 (dy) ditë pune. Faturimi do të kryhet sipas Sistemit Tarifor të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për çdo Grup Tarifor.

10.4 Specialisti i daljeve evidenton datën e dorëzimit të faturës konsumatorit në mënyrë që të mos cenohet afati prej 15 ditësh si e drejtë në bazë të kontratës, për përmbushjen e obligimit të pagesës.

11. Zbatimi dhe mbikëqyrja

11.1 Procedura zbatohet nga sektorët e leximit dhe faturimit në distrikte, ndërsa mbikëqyrjen e zbatimit të saj e bënë Departamenti i Faturimit në Divizionin e Furnizimit.

11.2 Çdo shmangie në zbatimin e kësaj Procedure konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës konform Kodit të Sjelljes dhe Etikës dhe të Rregullores për përgjegjësitë disiplinore të KEDS Sh.A.

12. Shfuqizimi

12.1 Kjo procedurë e zhvlerëson procedurën e mëparshme që rregullon lëmin e leximit dhe faturimit të konsumatorëve të grupeve tarifore.

13. Ndryshimi

13.1 Procedura mund të ndryshohet kohë pas kohe nëse konsiderohet e nevojshme, me kërkesën KEDS Sh.A, dhe me aprovim nga ZRRE-ja.

14. Hyrja në fuqi

14.1 Procedura hyn në fuqi në ditën e aprovimit të saj prej Bordit të ZRRE-së.

14.2 Procedura nxirret në gjuhën shqipe, dhe përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze, në rast të ndonjë mospërputhje gjuhësore në lidhje me kuptimin e shprehjeve në këtë procedurë, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.